

ABSTRAKT

Pushimi i hetimeve në Prokurorinë Themelore të Pejës gjatë periudhës 2016 - 2020

Qëllimi i studimit të kësaj teme është elaborimi i detajuar i të gjithave çështjeve që kanë të bëjnë me pushimin e hetimeve, sidomos shkaqeve që determinojnë pushimin e hetimeve. Gjatë zbatimit të hetimeve është me rëndësi gjetja e të vërtetës përkatësisht vërtetimi i gjendjes faktike të çështjes penale. Në të gjithë vendet e botës, në rajonin e Ballkanit si dhe në Kosovë çdo ditë e më shumë po rritet numri i veprave penale. Prokuroria është Institucioni që e zbaton hetimin e këtyre rasteve, andaj asaj i bie barra e mbledhjes së provave, të cilat do të dëshmojnë nëse një person që paraprakisht është i dyshuar, është fajtor ose jo për rastin konkret, gjë e cila do të vendosët më vonë në kuadër të vendimmarrjes gjyqësore. Andaj, në këtë punim do të trajtohen bazat mbi të cilat një prokuror i shtetit bazohet për t'i pushuar hetimet, në rastet kur mendon se personi konkret nuk është përgjegjës për veprën penale konkrete. Është fakt i njohur që intencat e shoqërisë tonë dhe asaj botërore janë që veprimet që ushtrohen nga prokuroria të jenë të drejta dhe të ligjshme.

Arsye kryesore e hulumtimit dhe trajtimit të kësaj teme, përveç tjerash është vënia në pah e rëndësisë, përparësive, mangësive, kushteve, afateve dhe efektit juridik të pushimeve të hetimeve, si dhe në anën tjetër vlerësimi i këtyre elementeve në drejtim të dhënies së propozimeve mbi ndryshimet e mundshme dhe eliminimin e të metave eventuale, që gjithmonë kjo procedurë të zhvillohet në pajtueshmëri me parimin e efikasitetit (shpejtësisë), parimin e të vërtetës materiale, si dhe mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të palëve në procedurë penale. Ky punim, ka për qëllim të pasuroj të dhënat e përgjithshme dhe shkencore mbi pushimin e hetimeve, pasi që ne jemi dëshmitar që në praktikën tonë gjyqësore, në raste të caktuara ndodh që procedura penale të stërzgjatet, ndonjëherë edhe në rastet më të thjeshta, qoftë si rezultat i formaliteteve të shumta apo edhe neglizhencës nga ana e prokurorëve. Duke u nisur nga kjo situatë, konkretisht ne pretendojmë që fillimisht të analizojmë legjislacionin tonë, literaturën shkencore dhe rastet praktike nga zhvillimi i kësaj procedure pranë Prokurorive dhe Gjykatave tona, si dhe paraqitjen e statistikave dhe mendimeve të ndryshme, në drejtim të ofrimit të të dhënave sa më të sakta dhe më të qarta në këtë fushë.

Mentori: Prof. Dr. Azem Hajdari

Kandidatja: Djellza Berbati